



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. 159, Datë 03/08/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 58, datë 07.05.2018, e Z. I. B., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “bindjes politike”, nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se ndërmjet ankuesit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., në datën 21.11.2016, është lidhur një kontratë individuale pune me afat të pacaktuar. Referuar kësaj kontrate rezulton se ankuesi është punësuar nga kjo shoqëri në pozicionin e Remontierit II (kualifikimi dhe kategoria) A3/3 pranë NJOB në Sektorin e Linjave/Brigada Bulqizë të OST sh.a.

Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 6265, datë 14.11.2017, të OST sh.a., Z. I. B. njoftohet se kjo shoqëri kërkon të përfundojë kontratën e punës me të. Referuar procesverbalit të takimit nr. 381, datë 20.11.2017, si dhe shkresës nr. 6265/2, datë 23.11.2017, të OST sh.a. drejtuar ankuesit,

rezulton se marrëdhëniet e tij të punës me këtë shoqëri ndërpriten me motivacionin “*mos plotësim i kriterëve të punësimit (kualifikimin dhe vjetërsinë në punë) të përcaktuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës dhe në Raportin Final të Auditit të Brendshëm*”.

Ankuesi pretendon se mbështetur në dëshminë e kualifikimit, të lëshuar nga EMCO, ai rezulton të ketë profesionin “Elektricitist”, Grupi III i Sigurimit Teknik dhe 25 vjet vjetërsi në punë, duke i plotësuar të gjitha kriteret për pozicionin e tij të punës. Njëkohësisht, Z. I. B. thekson faktin se punëdhënësi ka lidhur me të një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe paraprakisht lidhjes së kësaj kontrate, OST sh.a. dispononte informacionin përkatës, lidhur me kualifikimet dhe vjetërsinë e tij në punë, pasi kishte në administrim dosjen e tij personale. Në këtë kontekst, ankuesi pretendon se kontrata e tij e punës është ndërprerë për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar i Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI)¹ dhe anëtar i Këshillit të Bashkisë Mat², si përfaqësues i kësaj force politike.

Në vijim, Z. I. B. dërgoi pranë Komisionerit, shkresën nr. 624/1, datë 10.05.2018, nëpërmjet së cilës informon se OST sh.a. ka punësuar pranë Sektorit Bulqizë, 2 punonjës që nuk plotësojnë asnjë kriter pune, konkretisht shtetasit E.L. dhe G.K.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit të ankesës nr. 58, datë 07.05.2018, e Z. I. B., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
2. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Administratorit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me shkresën nr. 624/2, datë 15.05.2017, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesi.

¹ Referuar Kartës së Anëtarësisë Nr. 5726, datë 22.04.2016, të lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim .

² Mbështetur në vërtetimin e datës 30.04.2018, të Bashkisë Mat.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

- Në përgjigje të shkresës nr. 624/2, datë 15.05.2017, së Komisionerit, OST sh.a. dërgoi shkresën nr. 624/3, datë 24.05.2018, ku informon se Z. I. B. ka qenë i punësuar pranë OST sh.a. me detyrë Remontier II, Sektorit i Linjave/Brigada Bulqizë pranë Njesisë Operative Burrel. Në datën 25.12.2017, OST sh.a. ka përfunduar marrëdhënien e punës me Z. I. B., për shkak të mosplotësimit të kriterëve të punësimit. Zgjidhja e marrëdhënies së punës është bërë në respektim të neneve 141, 143, 144 dhe 153 të Kodit të Punës, lidhur me respektimin e afatit, procedurës dhe shkakut të përfundimit të marrëdhënies së punës, duke përmbushur çdo detyrim të OST sh.a., në cilësinë e punëdhënësit.

Duke mos qenë dakord me këtë vendim të OST sh.a., Z. I. B. ka paraqitur një kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, e cila me vendimin nr. 68, datë 30.04.2018 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së Z. I. B. si të pabazuar në ligj dhe në prova. Në lidhje me motivin e pretenduar nga Z. I. B. për përfundimin e marrëdhënies së punës, Gjykata është shprehur në arsyetimin e vendimit si më poshtë:

“.....Punëdhënësi nuk mund të tejkalojë të drejtën e tij për të zgjidhur kontratën për çdo lloj shkak. Konsiderohet tejkallim (abuzim me të drejtën) kur zgjidhja e kontratës është bërë nga punëdhënësi për motiv abuziv. Si të tilla motivet (shkaqet) abuzive në ndryshim nga shkaqet justifikuese janë të përcaktuara shprehimisht në ligj (neni 146) dhe janë të vetmet në llojin e tyre (motive shteruese). Nisur nga fryma e këtij neni barrën e provës për të vërtetuar motivin abuziv e ka vetë punëmarrësi.

Nga shpjegimet e dhëna nga paditësi si në kërkesëpadi, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u provua prej saj asnjë lloj motivacioni i pajustificuar konkret i ndërmarrë nga pala e paditur si shkak për largimin nga puna. Kjo pasi motivacioni i përcaktuar në vendimin për largim nga puna lidhet vetëm me mosplotësimin e kriterëve të punësimit (kualifikimin dhe vjetërsinë në punë të përcaktuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës dhe në Raportin Final të Auditit të Brendshëm).”

Bashkëlidhur informacionit të mësipërm, OST sh.a. ka përcjellë një kopje të vendimit gjyqësor nr 68, datë 30.04.2018, të gjykatës së rrethit gjyqësor Mat.

3. Nëpërmjet shkresës nr. 624/4 Prot., datë 30.05.2018, drejtuar OST sh.a. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kërkoi nga kjo shoqëri informacionin e mëposhtëm:

- Kopje e dosjes personale së Z. I. B. (diploma e shkollës së mesme/të lartë, listë notash, librezës së punës etj.);
 - Informacion mbi masat e marra nga ana juaj, për të gjithë punonjësit e tjerë të OST sh.a. Mat, të cilët, sikurse Z. I. B., kanë rezultuar se nuk plotësojnë kriteret e punësimit nga Raporti Final i Auditit të Brendshëm. Ndër të tjera është kërkuar që bashkëlidhur të përcillen aktet përkatëse të shoqërisë, ku reflektohen masat e marra për secilin prej tyre;
 - Informacion mbi arsimin dhe vjetërsinë në punë të personit, që ka zënvendësuar Z. I. B., në pozicionin e tij të punës. Bashkëlidhur kopje e dosjes personale të tij.
- Në përgjigje të shkresës nr.624/4 Prot., datë 30.05.2018, të Komisionerit, OST sh.a. dërgoi në adresë të tij, informacionin e kërkuar, si dhe e bën me dije Komisionerin se në zbatim të shkresës nr. 5203/4 Prot, datë 07.11.2017 “Dërgohet Raporti final i Angazhimit të Auditimit të Brendshëm”, kjo shoqëri ka ndërprerë marrëdhënien e punës me ata punonjës, të cilët nuk përmbushnin kriteret e punësimit për pozicionin e tyre të punës. Bashkëlidhur shkresës nr. 3649/5 të OST sh.a., janë dërguar shkresat për përfundimin e marrëdhënies së punës me punonjësit: I.K., S.K., SH.P., A.P., P.S., GJ.B.; kopje të dosjes personale të Z. I. B., si dhe kopje të dosjeve personale të Z. E. L. dhe Z. G. K., zëvendësues të Z. I. B..

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

☐ Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi:

Referuar dokumentacionit të depozituar, në cilësinë e provës nga të dy palët në proces, rezulton se Z. I. B. është punësuar pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. Mat, nëpërmjet kontratës individuale të punës me afat të pacaktuar⁴, në pozicionin Remontier II pranë NJOB, Sektori i Linjave/Brigada Bulqizë. Në vitin 2017, OST sh.a. në zbatim të Vendimit nr. 32, datë 11.10.2017, të Këshillit të saj Mbikqyrës, ka filluar implementimin e e strukturës së re organizative⁵. Paraprakisht, OST sh.a. ka krijuar një grup auditimi të brendshëm tematik, i cili ka kryer auditimin pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Në përfu ndim të auditimit, grupi auditues ka dalë me një Raport Auditimi, i cili i është përcjellë Drejtores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 5203/4, datë 07.11.2017.

⁴ Kontrata individuale e punës ndërmjet ankuesit dhe OST sh.a., është lidhur në datën 21.11.2016.

⁵ Referuar informacionit të marrë nëpërmjet vendimit nr. 67, datë 14.05.2018, të gjykatës së rrethit gjyqësor Mat;

Në këtë raport janë reflektuar problematikat përkatëse, të konstatuara në Sektorin e Personelit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Në kushtet kur njëra prej detyrave të grupit të audituesve ishte kontrolli i rregullshmërisë së kriterëve të punësimit të punonjësve të OST sh.a, që nuk përmbushnin kriteret e miratuara në Vendimin nr. 11, datë 06.05.2016, e Këshillit Mbikqyrës së OST sh.a., “Për miratimin e kriterëve të punësimit në OST sh.a.”, në Raportin e Auditimit ishin reflektuar të gjithë mangësitë në këtë drejtim, duke identifikuar të gjithë punonjësit që nuk plotësonin kriteret e pozicionit të punës. Në këtë Raport⁶ është konstatuar se: “I. B., aktualisht *remontier i dytë në linja*. Sipas kriterëve të miratuara, ky vend pune kërkon arsimin e mesëm elektrik/i mesëm dhe i ulët me kualifikim të lartë elektrik dhe eksperiencë jo më pak se 2 vjet”.

Referuar dokumentacionit të dosjes personale të ankuesit, rezulton se ai ka kryer arsimin e mesëm profesional, dega Agronomi. Z. I. B. ka filluar punë pranë OST sh.a. në datën 21.11.2016, menjëherë në pozicionin “*remontier i dytë*” dhe ka eksperiencë pune më pak se dy vite.

Në Kapitullin III, të Vendimin nr. 11, datë 06.05.2016, të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a. parashikohet shprehimisht:

“*Specialist në sektorin e Linjave që mbulon funksionet remontier, saldator dhe fillrojtës duhet të ketë:*

- *Arsimi - i mesëm elektrik/i mesëm dhe i ulët me kualifikim të lartë elektrik.*
- *Eksperiencë – jo më pak se 2 vjet.*”

Në kushtet kur, ankuesi nuk plotësonte kriteret për pozicionin e punës, ndaj tij është filluar procedura për zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Referuar vendimit nr. 67, datë 14.05.2018, të gjykatës së rrethit gjyqësor Mat, kjo procedurë ka qenë e rregullt dhe nga pala e paditur OST sh.a. janë respektuar kushtet ligjore për një zgjidhje të rregullt të kontratës së punës. Me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, ankuesi ka përfituar pagën e një muaji për afatin ligjor të njoftimit, mbështetur në nenin 143, të Kodit të Punës; pagën në formë shpërblimi për pushimet e pakryera, në referencë të nenit 94/5 të Kodit të Punës. Marrëdhëniet e tij të punës me OST sh.a. janë ndërprerë në datën 30.11.2017, ndërsa marrëdhëniet financiare janë ndërprerë në datën 25.12.2017, në fund të afatit ligjor të njoftimit.

⁶ Referuar Rubrikës IV “Gjetje dhe konkluzione”, gërma a) “Rregullshmëria e kriterëve të punësimit”, të Raportit të Auditimit.

OST sh.a. e ka njoftuar Komisionerin, se ankuesi I. B. e ka paditur shoqërinë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Mat, ku objekti i padisë konsistonte në dëmshpërblim page. Me vendimin e sipërpërmendur të kësaj gjykate është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë së Z. I. B.⁷.

Referuar vendimit nr. 67, datë 14.05.2018, të gjykatës së rrethit gjyqësor Mat, shkaku për të cilin është zgjidhur kontrata e punës ndërmjet OST sh.a. dhe Z. I. B. ka qenë se Z. I. B. nuk ka aftësinë e duhur për të punuar si: *Remontier II pranë NJOB, Sektori i Linjave Brigada Bulqizë*. Kjo për faktin se ai nuk plotëson tërësisht kriteret e punësimit siç janë kriteret e miratuara me Vendimin nr. 11, datë 06.05.2016, të Këshillit Mbikqyrës “Për miratimin e kriterëve të punësimit në OST sh.a.”, si dhe ato të miratuara dhe në Vendimin nr. 31, datë 11.10.2017, e Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a. “Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të OST sh.a.”

Në vendimin gjyqësor është theksuar se: *“Pretendimi i paditësit se ai ka Dëshmi Kualifikimi për Sigurimin Teknik”, grupi III, çka për paditësin do të thotë se ka kualifikim të lartë elektrik nuk është i bazuar, pasi kjo dëshmi nuk përfaqëson apo nuk tregon kualifikimin profesional elektrik të parashikuar në kriteret e punësimit, por vetëm atë të sigurimit teknik, që në fakt edhe në këtë rast nuk është i lartë, pasi ai ka grupin e III-të dhe ai i lartë është grupi IV”*.

Nëse i referohemi sërish Raportit të Auditimit kontatohet se, përveç Z. I. B., kriteret për pozicionin e punës nuk i plotësojnë edhe punonjës të tjerë të OST sh.a., të cilët jo domosdoshmërisht kanë bindjet politike të ankuesit. Referuar informacionit të përcjellë nga OST sh.a rezulton se ndaj punonjësve që kanë rezultuar se nuk plotësojnë kriteret e parashikuara për pozicionin e tyre të punës, përkatësisht ndaj I.K., S.K., SH.P., A.P., P.S., GJ.B., janë zgjidhur kontratat individuale të punës.

Lidhur me personat që e kanë zëvendësuar Z. I. B. në pozicionin e tij të punës, përkatësisht Z. E. L. dhe Z. G. K, referuar dokumentacionit të përcjellë nga OST sh.a.⁸, rezulton se Z. E. L. ka përfunduar Shkollën Profesionale Elektrike të Nivelit të Parë Bulqizë, mbi bazën e së cilës i është dhënë çertifikata e përgatitjes profesionale e nivelit të parë si elektrik i përgjithshëm. Z. G. K. ka përfunduar Shkollën e Ulët Teknike Profesionale, Dega Motorrist, Kategoria III, si dhe në përfundim të kursit të plotë (400 orë), që ka ndjekur në kuadër të programit punëformues, ka fituar zanatin “Elektricitist”.

⁷ Z. I. B. e ka ankimuar pranë gjykatës së apelit, vendimin nr. 67, datë 14.05.2018, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat,

⁸ OST sh.a. nuk ka dërguar informacion mbi vjetërsinë e tyre në punë.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesi nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e OST sh.a..

Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë të ankuesit, Komisioneri gjykon se nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkakun e pretenduar nga Z. I. B., nga ana e OST sh.a.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 9, pikat 1-2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12 e 13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “*bindjes politike*”, të Z. I. B., nga ana e OST sh.a.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda afateve ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak: Bindja politike
Fusha: Punësim)